REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 149/17
Datë/Datum. 05.06.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit **Komuna Viti**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Visar Basha – Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Ekspertiza lidhur me Ankesën Nr. **149/17** e OE **"AB Clean"** - Lipjan.		
Datë:	05.06.2017		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Kosovës ju njoftojmë me raportin e ekspertizës, lidhur me ankesën e parashtruar me dt: 22.05.2017 me Nr. **149/17** nga OE **"AB Clean"** - Lipjan, për shqyrtimin e lëndës: **"Shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtjes së objekteve komunale, shëndetësore dhe arsimore"**, me numër të prokurimit: 657/17/983/221, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Viti.**

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA VITI.**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues – **AB CLEAN.**

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		25.05.2017		**25.05.2017**		**05.06.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 22.05.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **149/17** e parashtruar nga OE **"AB Clean",** me seli në Lipjan, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtjes së objekteve komunale, shëndetësore dhe arsimore"**, me numër të prokurimit: 657/17/983/221, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Viti.**
Konform nenit 113 te Ligjit Nr. 04/L-042, Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Komunës së Vitisë (KV).**

N.111 i LPP-së - Operatori Ekonomik Ankues "AB Clean", me seli në Prishtinë.

Pikat e Ankesës nga OE **"AB Clean"** *- dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

- Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Nenit 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi
- Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave,
- Neni 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi,
- Neni 72 Dokumentacioni dhe informacionishtesë

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:
Në vazhdim të kësaj ankese do të përpiqemi që të argumentojmë shkeljet e pretenduara të:

Të dispozitave të LPP-se në RK.

- **Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**

Rekomandimi i Komisionit për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit që, tenderi i OE NTSH AB" Clean " te eliminohet nga aktiviteti i me tejme i prokurimit edhe përkundër asaj qe i ka plotësuar kushtet formale administrative te pjesëmarrjes ne tender si dhe te shpërblehet me kontratë oferta e operatorit ekonomik SAF SHPK me qmim prej 109 O43.64 euro qe per nga per nga çmimi eshte me e shtrenjte dhe është ne kundërshtim me nenin 6 të LPP-së në RK, duke i dëmtuar rende fondet publike dhe burimet publike ne shume eprej 7 226.76 euro. Ligji parasheh obligimin e çdo Autoritet publike janë te obliguara qe te sigurojnë qe fondet publike dhe burimet publike te përdoren ne mënyrën me ekonomike njëkohësisht duke marre ne konsiderate lenden e prokurimit.

- **Nenit 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi**

Rekomandimi i Komisionit për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit që, tenderi i

OENTSHAB" Clean "te eliminohet nga aktiviteti i me tejme i prokurimit edhe përkundër asaj qe i ka plotësuar kushtetformale administrative te pjesëmarrjes ne tender si dhe te shpërblehet me kontratë oferta e operatorit ekonomik te shpërblyer me kontrate ka qen ne kundërshtim me nenin 7 të LPPsë në RK, duke favorizuar ofertën e këtij operatori dhe duke diskriminuar ofertën e OE te lartpërmendur.Pabarazia ne trajtim si dhe favorizimi si dhe diskriminimi është bere nga ana e AK ne procedurën e kualifikimit dhe përzgjedhjes me rastin e eliminimit te ofertës se NTSH "AB Clean" Ligji parasheh obligimin e çdo Autoritet kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminues dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

- **Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave**

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar ne kundërshtim me neni 56, paragrafin 1.1 dhe paragrafi 1.2 te LPP-se ne Republikën e Kosovës.Ne vijim po citoj dispozitat e nenit 56. paragrafi 1.1 dhe 1.2 te këtij ligji,

Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes: 1.1. së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji; 40 1.2. së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në nenin 6o të këtij ligji.Nëse i referohemi Letrës standarde të tenderuesit të eliminuar, te dërguar nga AK. KKVitisë arsyeja per eliminimit është: Se nuk e keni plotësuar kriteret sipas FDT, nuk keni plotësuar Specifikimet e det. Teknike dhe nuk keni Plotësuar kushtin per tri referenca per tri vitet e fundit.Pretendojmë se Komuna e Vitisë ka dështuar në kualifikimin dhe përzgjedhjen e operatoreve ekonomik konformë kushteve formale administrative të pjesëmarrjes në tender të përcaktuara në Njoftimin për kontrate dhe në FDT te dosjes se tenderit ne momentin kur ka vlerësuar se Oferta e kompanisë NTSH AB Clean, është e pa përgjegjshme ne kuptim te dispozitave te LPP-se. Arsyet e eliminimit nuk qëndrojnë dhe janë ne kundërshtim te plote me kërkesat formale administrative te pjesëmarrjes ne tender. Ne vijim te kësaj ankese do te argumentojmë këto pretendime:

1. Sa i përket arsyes se pare se nuk kemi plotësuar Specifikimet e detyrueshme teknike kjo arsye nuk qëndron sepse ne ju kemi ofruar ketë dëshmi edhe pse nuk ka qen e specifikuar si kusht per kualifikim dhe përzgjedhje ne FDT te dosjes se tenderit.

2. Ndërkaq per arsyen e dyte se ne nuk kemi plotësuar kushtin per tri referenca per tri vitet e fundit, edhe kjo arsye nuk qëndron sepse AK KK Vitise ne FTD e dosjes se tenderit ne paragrafin 9.1 te Kërkesat e kapacitetit teknik ose profesional - Kapaciteti teknik dhe profesional keni kërkuar nga OE te ofrojnë deshmi te dokumnetuar : 1.Lista e kontratave të shërbimeve qe kane te bëjnë me me pastrime te objekteve ose shërbime të ngjajshme kontrata te realizuara nga Operatorit ekonomik ose grup Operatoresh, Minimum një kontratë, bashke me referencen, qe don te thot se ne kemi ofruar dy kontrata dhe dy referenca dhe me këtë kemi përmbushur kërkesat e dosjes se tenderit te përcaktuara ne FDT.

3. Sa i perket arsyes se trete te përshkruar ne kerkesen per rishikim te vendimit se nuk kemi ofruar deshmi mbi pronesine e automjetit-kopjen e librezes se qarkullimit per Bikap nuk qendron sepse ne ne

dosje te tenderit kemi ofruaar foto se bashku me kopjen e librezZes se automjetit. Vlen te theksohet se arsyet e eliminimit te arsyetuara ne Letrën standarde te eliminimit dhe ne Vendimin per refuzim te kerekses per rishikim nuk korrespondojnë me Raportin mbivlerësimin e tenderëve.Duke pasur parasysh eto fakte me plote te drejte mund te konstaojme se AK. Komuna e Vitisë ka bere shkelje te dispozitave te nenit 56 paragrafi 1.1 te LPP-se.

- **Neni 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi,**

Pretendojmë se AKKKVitisë përmes Komisionit për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për të trajtuar ofertën e kompanisë NTSH "AB CLEAN" si oferte e pa përgjegjshme dhe si rrjedhoje e kësaj te eliminoj nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit ka vepruar në kundërshtim me neni 59, paragrafin 2, dhe 4 te LPP-se ne Republikën e Kosovës.

Në vijim po citoj dispozitat e nenit 59. paragrafi 2 dhe 4 të këtij ligji:

2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Pretendojmë se AK -Komuna e Vitisë ka dështuar në vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit, duke vlerësuar gabimisht ofertën e NTSH AB Clean si oferte e pa përgjegjshme. Komisioni për vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e këtij në ligji në momentin kur ka vlerësuar se tenderin ne kundërshtim te plote me kërkesat formale administrative te pjesëmarrjes ne tender te përcaktuara ne FDT te dosjes se tenderit dhe ne Njoftimin per kontrate. Të ju përkujtojmë se kërkesat për kualifikim dhe përzgjedhje të OE janë të përcaktuara në Njoftimin për kontrate dhe në FDT të dosjes së tenderit. Me fjalë të tjera ne kemi plotësuar kërkesat minimale kualifikuese te përcaktuara ne dosjen e tenderit, paragrafi 7,8, 9 13 dhe 14 përkatësisht kërkesat e për caktuara në LPP-së, në nenin 65, 66, 68 dhe 69 të LPP-së. Në paragrafin 27 të Informacioneve per tenderuesit te dosjes se tenderit ne mënyrë detale është e parashikuar vlerësimi dhe ekzaminimi, krahasimii tenderit. Citoj dispozitat e këtij paragrafi;

27.1 Tenderët e pranuar me kohë do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në bazë të procedurës së përcaktuar në Rregulloren e Prokurimi Publik.

27.2 Tenderi konsiderohet të jetë i përgjegjshëm kur:

a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të kësaj dosjeje të tenderit;

b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në këtë dosje të tenderit;

c. është dorëzuar nga operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të në këtë dosje të tenderit duke mos u larguar substancialisht nga to dhe duke mos u bashkangjitur atyre kufizim.

Duke pasur parasysh këto fakte pretendojmë se tenderi i jone ka qen ne përputhshmëri te plote me paragrafin a,b, dhe c te dosjes se tenderit.

- **Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë**

Pretendojmë se AK KK Vitisë përmes Komisionit për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për të trajtuar ofertën e kompanisë NTSH "AB CLEAN" si oferte e pa përgjegjshme dhe si rrjedhoje e kësaj te eliminoj nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit ka vepruar në kundërshtim me neni 72 , paragrafin 1, 2 dhe 3 te LPP-se ne Republikën e Kosovës.

Citojmë dispozitat e nenit 72 te LPP-se.

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afatite caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës. 2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji. 3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit përdorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Duke pasur parasysh këto fakte pretendojmë qe AK KK Vitisë nuk ka shfrytëzuar mundësinë ligjore qe edhe nëse OE nuk i ka dorëzuar dëshmitë e kërkuara ne baze te kërkesave te AK-se , te kërkoj nga OE qe te plotësoje apo te Sqaroj dokumentet e paraqitura ne pajtim me nenin 65-71.

Edhe një here po theksojmë se ne i kemi dorëzuar ne dosje te gjitha dëshmitë koforme kërkesave te FDT se dosjes se tenderit.

PERFUNDIM

Duke pasur parasysh këto fakte kërkojmë nga organi kompetenti OSHP-se që:

- Të aprovoj ankesën si të bazuar,
- Të anuloj, Vendimin për eliminimin nga aktiviteti i prokurimit për tenderin e lerteshenuar,
- Te anuloj Vendimin per dhenie te kontrates,
- Të kthej tenderin në rivlerësim dhe vlerësimi të bëhet në pajtim me kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në FDT të dosjes së tenderit.

Mbetemi me shprese ankesa e jone do të shqyrtohet pozitivisht.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP :	24.03.2017
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Shërbime/vlerë e mesme
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):	12.04.2017
Data e hapjes së ofertave	12.04.2017-14:00^{h}
Kriter për dhënie të kontratës:	*Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët*
Lloji i kontratës:	*Kontratë kornize – 12 muaj*

Kriteret për vlerësim

III.2)KUSHTET PËR PJESËMARRJE

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale

Kërkesa 1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
Kërkesa 2. Regjistrimi i Numrit fiskal
Kërkesa 3. Regjistrimi i tvsh-s

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmi 1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit).
Dëshmi 2. Kopja e certificates së Numrit fiskal
Dëshmi 3. Kopja e certificates së TVSHs

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
N/A

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

1. Kontratave të shërbimeve qe kane te bëjnë me me pastrime te objekteve ose të ngjashme , qe Operatorit ekonomik ka realizuarane tri vitet e fundit (2014-2015-2016)
2.Mjetet te kompanisë, makina dhe automjete, te paraqitur, te dorëzoj dëshmi mbi pronësinë, (se paku një automjet Pickup)
3. Specifikimi i veglave dhe mjeteve te cilat posedon kompania dhe disponueshmëria ne përdorim. Lista e pajisjeve se paku 10 makina thithëse, dhe , makina për larjen e dyshemesë se paku 1 copë.
4.Punetor ne evidencat e kompanise, numrit te punëtorëve të jetë min. 30.
5. Një menaxher per udheheqjen e sherbimeve ne kompani, te jete me fakultet ose ngritje profesionale Bach. dhe te kete pervoje 5 vjeqare

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Lista e kontratave të shërbimeve qe kane te bëjnë me me pastrime te objekteve ose shërbime të ngjajshme kontrata te realizuara nga Operatorit ekonomik ose grup Operatoresh, Minimum një

kontratë, bashke me referencen
2. Lista e mjeteve te kompanise, lista origjinale nga OE ose kontrate per shfrytezim me qira, dhe libreza e regjistrimit
3. Lista e veglave dhe mjeteve te punes, origjinal e vulosur dhe nënshkruar nga OE, ose kontrata me qira
4. Lista e numrit te punëtorëve ne evidencat e kompanise e vulosur dhe origjinal të jetë min. 30, duke ofrura parakontrate per punetoret
1. Te ofroj deshmi per ngtijen profesionale , Dipl. te noterizuar, CV dhe kontrate ose parakontrate per angazhim te perkoheshem,dhe Nje vendim i vulosur nga OE per caktimin menaxher te projektit.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	"Saf"		109,043.64€	JO
2.	"Schafberger"		79,994.95€	JO
3.	"Clean"		86,000.00€	JO
4.	"Sfk"		100.019.00€	JO
5.	"AB Clean"		101.816.88€	JO
6.	"Krasniqi"		117,298.56€	JO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- Xhelal Veseli - Kryetar i komisionit
- Muhamet Tahiri - Anëtar i komisionit
- Enes Pira - Anëtar i komisionit

Data e mbarimit të vlerësimit: 03.05.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....04.05.2017

Data e njoftimit të Dhënies së Kontratës në faqen e Krpp-së :.....05.05.2017

Sipas raportit të komisionit të vlerësimit ofertat të PËRGJEGJSHME janë:

Nr.	Emri i tenderuesit të Përgjegjshëm	Çmimi i ofruar	Radhitja sipas çmimit
1.	**Saf**	**109,043.64€**	**1**

Raporti i komisionit vlerësues:
Komisioni pasi i ka vlerësuar ofertat ka rekomanduar për kontratë "SAF".

Neni 54 i LPP-së – Njoftimi i kandidatëve - Tenderuesve

AK-ja, konform nenit 54 të LPP-së dhe nenit 37 të Udhëzuesit Operativ për Prokurimit Publik, i njofton operatorët ekonomik me letrën standarde.

Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Pas pranimit të letrës standarde OE ankues konform nenit 108/A ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, me ç'rast AK-ja, ja refuzon ankesën si të pa bazuar.

Përgjigjet e ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimet ankimore të OE ankues:

Sqarimi nr.1

OE ankues pas parashtrimit te ankesës pran AK-se, i ka kundërshtuar pikat e eliminimit dhe AK-ja, pas rishqyrtimit, piken lidhur me kontratat dhe referencat e ka aprovuar.

Ne vendimin e AK-se, lidhur me kërkesën për rishqyrtim AK-ja, i ka cekur dy arsye te eliminimit:

Mos vulosja e specifikimeve teknike dhe mungesa e dëshmisë lidhur me automjetin – Pickup.

Sqarimi nr.2

Lidhur me arsyetimin se AK-se, se nuk i ka vulosur dhe nënshkruar specifikat teknike, eksperti shqyrtues, vlerëson se nuk është i qëndrueshëm ky arsyetim për eliminim te operatorit ekonomik, për faktin se, te specifikimet teknike janë dhënë vendet/objektet ku do te behet mirëmbajtja dhe një pjesë e vogël është me furnizim.

Sqarimi nr.3

Lidhur me arsyen e dyte te eliminimit, eksperti shqyrtues fillimisht sqaron se OE ankues nuk ka ofruar dëshmi - librezën për automjetit Pickup, te cilat e ka kërkuar AK-ja, ne dosje te tenderit ne piken 9.1.2 te FDT-se. Eksperti shqyrtues lidhur me këtë kërkesë sqaron se OE ankues ka ofruar ne ofertën origjinale vetëm një deklaratë me shkrim dhe disa fotografi.

Eksperti shqyrtues, mendon se konform nenit 72 te LPP-se mund te kërkohen sqarime lidhur me pronësin e automjetit i cili duhet te dëshmoj konform kërkesës se dosjes se tenderit konkretisht pikës 9.1.2 te FDT-se.

Ndërsa ne lidhje me kontratat dhe referencat e OE ankues, eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja, pas rishqyrtimit te kërkesës se OE ankues e ka eliminuar si pike te eliminimit për faktin se e plotëson këtë kërkesë.

Sa i përket pretendimit te OE ankues për shkelje te nenit 7 te LPP-se, nuk është i qëndrueshëm për faktin se pas analizimit te shkresave te lendes nuk ka vërejtur diskriminimin apo trajtim te pabarabartë ne mes te OE-ve.

Eksperti shqyrtues vlerëson se nuk janë vlerësuar ofertat konform nenit 59 te LPP-se, për faktin se mund te kërkohen edhe disa sqarime nga OE ankues lidhur me pronësin e automjetit sipas nenit 72 te LPP-se. andaj, pretendimet ankimore për shkelje te dispozitave te LPP-se te përmendura ne ankesë janë pjesërisht te qëndrueshme.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

- Eksperti shqyrtues bazuar në konstatimet e cekura në ekspertizë mendon që Autoriteti Kontraktues – **Komuna Viti (KV)**, për aktivitetin e prokurimit: **"Shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtjes së objekteve komunale, shëndetësore dhe arsimore"**, me numër të prokurimit: 657/17/983/221, nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së.
- Prandaj eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ta anulojë vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe propozon që ky aktivitet i prokurimit të Rivlerësohet, ndërsa ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar.